



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

### **Nr. 55**

Datë: 26.10.2017, ora: 10:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Stevan Veselinoviq, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP

Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

---

### **RENDI I DITËS**

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.53 /2017*

2. Raport nga Sekretariati;

3. Aktivitetet e ZRPP-së;

- *Rekomandim për anulimin e ID-kartelave të vëzhguesve të subjekteve politike;*

4 .Raport i Këshillave të KQZ-së ;

Këshilli për Operacione Zgjedhore;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit operacional për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2017;*

5. Të ndryshme;

## **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.53 /2017*

**Valdete Daka:** Mire se keni ardhur në mbledhjen e 55 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me rend dite sikurse e keni para jush. A ka dikush vërejtje, propozime për këtë rend dite?

**Adnan Rrustemi:** Jo, veç me aq sa pash po mungon pika e raportit të QNR-ës në rend dite.

**Valdete Daka:** Atëherë kush është për këtë rend dite me këtë shtesë?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.53 /2017*

**Valdete Daka:** Pika e parë shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit numër 53. A ka dikush vërejtje në këtë procesverbal? Nëse jo kush është për?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin e KQZ-së nr.53 /2017*

**Valdete Daka:** Pikë e dytë raport nga sekretariati. Nuk ka raport tjetër, e heqim këtë pikë e qesim raport nga QNR-ja.

**Adnan Rrustemi:** Para se me fillua Burimi, një pyetje për Krye shefin për një informacion për votime jashtë vendit...A ka përfundua procedimi i fletë votimeve, sa janë proceduar si të ligjshme në këtë raste, në këtë aktivitet që është zhvilluar këto 2-3 ditë ?

**Burim Ahmetaj:** Kryetare e nderuar, dhe anëtarë KQZ-së, ju njoftoj se në Qendrën e Numërimit të Rezultateve është duke vazhduar në proceset dhe zhvillimet e qendrës së numërimit të rezultateve, dhe në kohën kur jemi duke raportuar jemi në procesin e futjes së dhënave të rezultateve dhe sanimit të problemeve përfundimtare të votuesve. Deri më tani, raporti nga ora 8 i mëngjesit të datës 26 tetor 2017, janë proceduar materialet si në vijime: Formularët e rezultateve janë proceduar 95.37% të tyre dhe për kuvend komunal, 41.40% formularët e rezultateve të kandidatëve prej 48%, lista përfundimtare e votueseve duhet deri në 60% . Deri më tani, jemi duke angazhuar për s animin e rezultateve, te cilat do të publikohet në veb faqen e KQZ-së dhe deri me tani janë te publikuar në komunat prej tyre tani janë edhe 5 të gatshëm të publikuar. Edhe 4 komuna të tjera janë në proces në sanimin e tyre gjatë ditës dhe do ta miratojmë në procesin e skanimit te formularëve të rezultateve. Pra, sot në QNR, po ashtu bëhet edhe pranimi i votueseve, i fletëvotimeve me postë që është konfirmuar edhe në shërbimin që do të dërgohet në dorëzim pranimi i fletëvotimeve me postë. Plus, jemi në pritje për të proceduar fletëvotimeve me kusht të cilat, do të nënshtrohen në bazë të dhënave që të krahasohen me votuesit. Me kusht, po mendoj me votuesit e rregullt që të kemi raportin e tyre, pastaj të numërojmë numërimin e tyre. Kjo është sa i përket procedimit të materialit në futjen e të dhënave dhe, të gjitha mundë të japin materialet dhe procedimin e materialeve. Gjatë pranimit të materialit të ndjeshëm në numrin e vendvotimeve, nuk ka mundur të pranohet si me rregull, te parregullsive gjatë pranimit pranimi edhe pse ka përfunduar sipas dinamikës. Më 24 tetor, në orët e hershme të mëngjesit është përfunduar edhe numërimi i fletëvotimeve që do të procedohet edhe si i rregullt, pra i kemi klasifikuar edhe rastet i kemi edhe në tabelë. E kemi një rast që është shoqëruar në karantinë, dhe rastet e tjera të cilat janë raste që

përfshijnë edhe fletëvotimet e rregullta për kryetar komune dhe në vende votime komunal, dhe në rastet të cilat edhe me zarfet e fletëvotimeve, e që në raste të caktuara me përputhjet edhe me shkrimet e një zarfi, apo dy zarf.

Janë identifikuar, tha z. Ahmetaj nga të gjitha ato rastet, dhe i kemi identifikuar. Pra, janë klasifikuar 111 raste, dhe i rekomandoj KQZ –së sikurse është edhe në tabelën para jush, pra të procedohen të rregullta për shkak se të gjitha këto janë në rregull, dhe se janë proceduruar në KKZ-të. Mirëpo, në QNR pas mundë të procedohen edhe si me rregull me vota, duke i rekomanduar si me vota të procedohet, si te rekomandimi. 24 raste të tjera, i rekomandohet KQZ-së të shkohet edhe në rinumërim: prej tyre 4 vendvotime janë, edhe 21 vendvotime janë për Kuvendin Komunal për arsye se, pse nuk mundë të procedohen të rregullta, pra të rekomandohet edhe në mospërputhje të tyre. Pra, ka raste të mos përputhjes së futjes se dhënave, e arsyet tjera në disa raste janë se mungojnë edhe nënshkrimet e kryesueseve të vendvotimeve. Kemi formular të rezultateve të paplotësuara, po ashtu edhe ato rezultateve të paplotësuara në raste tjera kur mungojnë edhe, si edhe në raste kur shiritat e vendvotimit janë të ndryshme.

Të gjitha këto raste, tha z. Ahmetaj, nuk kanë mundur të vlerësohen si prej rastit të cilat mundë të procedohen të rregullta, dhe i rekomandohet komisionet qendror të zgjedhjeve që të rinumërohen: janë 4 vendvotime për kryetar komune si vend votime për kuvendin komunal, ndërsa 27 raste të tjera janë që ndërlidhen në rastin të fletëvotimeve me kusht që, nënkupton se nuk ka pasur përputhje mes 21 nënshkrimeve dhe numrit të zarfeve të fletëvotimeve me kusht, apo në raste të caktuara me kusht të fletëvotimeve, pra mosrespektimi i procedurave...Janë 27 raste, e që janë në tabelën në të cilën janë edhe arsyeja se pse kanë shkuar në kuti hetimi. Në bazë të të gjeturave të hetimit, pra të hijezuara i keni të gjitha ato me të cilat rekomandohet komisionet zgjedhor për rinumërim.

Kjo, tha Ahmetaj, është sa i përket procedimit të materialeve të cilat kanë shkuar në karantinë, dhe nevojitet edhe në KQZ që të procedohen se janë në rregullt për t'i rinumëruar ato të cilat janë në rinumërimin e tyre, si dhe ato zarfe që nuk përputhen me përshkrimin, dhe ato zarfe në numrin e nënshkrimeve, po ashtat të bashkangjitur e keni edhe tabelën e cila tregon edhe procesin e futjes së të dhenve edhe për secilën kategori, pra kjo është sa i përket raportit të Qendrës së Numërimit të Rezultateve, dhe shpresojmë t'i jepet prioritet edhe të procedojmë më tutje...

**Ilir Gashi** : Para se gjithash, dua që të falënderojë QNR-në se, është duke e bërë një punë të mirë dhe efikase, dhe në të njëjtën kohë dua që të përshëndes të gjitha aktoret që janë të përfshirë në procese zgjedhorë dhe të cilët vërtetë meritojnë lëvdata. Kemi kaluar një proces të mirë, të meritueshëm për nga komplimentet por, dua me ditë nga Burimi nëse ka mundësi përfaqësisht, me na dhënë një datë të përfaqërt se kur do të përfundoje procesi lidhur me numërimin...Ka ankesa të shumta nga kandidatët për Këshilltar Komunal, ndonëse këtu po shihet se ka hy 19 % e rezultateve, d.m.th., a është edhe ky 19% pjesë e publikimit të pranimit të formularëve, apo nga një pjesë tjetër nga ajo që është rezultat që është skanuar...?

**Burim Ahmetaj**: QNR, pothuajse është paralel me të gjitha për numërim të rezultateve, dhe prioritet ju kemi dhënë formularëve për kryetar komune, e ku e kemi edhe një progresi të madh në këtë aspekt. Janë shume procese të tjera, por edhe pranimit i listës përfundimtare dhe regjistrimi në mënyra që të bëhet numërimi i fletëvotimeve me kusht. Mirëpo, pavarësisht kësaj jemi duke punuar në 3 ndërrime, dhe që të procedohet në një formularë, dhe krejt rezultatet 19 prej tyre, dhe 19.48% të procedohen të

kompletuara. Ky numër i tyre, është që të procedohet edhe si finale, mirëpo edhe një numër të tyre për auditim janë për shkak të parregullsive. Jemi duke e përgatitur procesin e raportit të auditimi, i cili shumë shpejtë do të silltet para Komisioni Qendror të Zgjedhjeve. Mirëpo, kjo nuk nënkupton që janë të skanuara, ne vetëm i kemi publikuar në veb- faqen e KQZ-së, por besoj që do ta kompletojmë rezultatin dhe nëse punojmë në 3 ndërrime, besoj se shume shpejt do të bëjmë një progres...

**Adnan Rrustemi:** Faleminderit. Në radhë të parë, po vërehet një progres edhe për nga raporti që presim edhe një raport në futjen e të dhënave për kryetar komune. Pajtohemi me Burimin që me ju dhanë prioritet që sa më parë që t'i certifikojmë edhe rezultatet, dhe të jemi gati për raundin e dytë. Natyrisht që duhet të procedohen, por unë kam disa çështje që ma shumë janë teknike. Po më intereson votat me kusht: si do të numërohen, a do të numërohen njëjtë apo bashkërisht edhe si për kuvend komunale, si për kryetare komune, gjithmonë duke pasur parasysh që neve na duhen votat me kusht për sa më parë për kryetarë komune. Të jemi gati për procedim, na duhen domosdoshëm që për kryetar komune për balotazh. A është e mundur me u numëruar vetëm për kryetar komune apo jo? E dyta, kur jemi për fletëvotimet me kusht, konsideroj që është i nevojshëm pak një analizim, një analizë ma e gjatë me ja bo votimit me kusht dhe me u siguruar që s'ka votua askush më shumë se një herë, por kjo ka kohë që është e ndërlikuar... Nga raporti që kemi marrë, ka një lloj mos përputhje të numrit të atyre që kanë votuar me kusht në bazë të komunave. Ka komuna që ka për mbi 100.000 banorë, dhe në ato që kanë votuar 300-400 persona me kusht, ndërsa ka edhe komuna që ka përmbi 100 votues që kanë votuar me kusht, është edhe një lloj disproporcioni i madh që mendoj se duhet me u pa se nga ka ardhur. Me e kuptuar se pse ka ndodhë kështu!

Në të njëjtën kohë, tha z. Rrustemi, është i nevojshëm një operacion për numrin e fletëvotimeve të pavlefshme për kuvende komunale, e që ende nuk e dimë se cila ka qenë masa e votuesve që kanë votuar se thjeshtë, për fat të mirë nuk e kemi marrë një shifër të madhe por, edhe në të njëjtën kohë nuk e dimë për votimi për kryetar komune... Po ashtu, një aspekt tjetër që ndërlikohet duke ju referuar të dhënave preliminare: në disa komuna, ka shpërputhje në mes të fletëvotimeve të vlefshme në kuti, dhe numrit të tërësishëm të gjithë kandidatëve në atë komunë, e që ishte dashur të përputhej kjo, nëse janë 500 fletëvotime të vlefshme në kuti, rrjedhimisht ishte dashur me qenë të shpërndara këto 500 fletëvotime në 5 ose 6 kandidatë që kanë garuar. Kur i mbledh të gjitha votat e kandidatëve, dalin më pak se sa që ka vota të vlefshme, ndoshta është një gabim në raportim por, ne duhet m'u siguruar nga ka rrjedh kjo gjithmonë duke ju referuar Ki- votës, dhe publikimit online. Në raport është mirë, sepse nga dokumentet që kemi marrë mbrëmë, sado që ka informacione të mjaftueshëm të detajuara, nuk ishte e qartë se cila kuti shkon në rinumërim për kuvende komunale, dhe cila shkon vetëm për kryetar komune, cilat shkojnë për të dy rastet...!? T'i na shpjegoje me fjalë, dhe në disa raste tregojë për kryetar komune, por rastet tjera nuk tregojë, rrjedhimisht e kishim të vështirë të kuptonim se sa kuti shkojnë, por e thatë në prezantim: 4 për kryetar komune, dhe 21 për kuvende komunale...!

Edhe një pyetje krejt teknike që m'u ka dukur e nevojshme. Ka zarfe të fletëvotimeve me kusht, dhe rekomandohet me e anuluar një zarf. Proceduralisht, qysh vendosni me anuluar pikërisht atë zarf...?

**Burim Ahmetaj:** Votat me kusht, nuk jemi të gatshme momentalisht me filluar numërimin e tyre, mirëpo posa të kompletohet skanimi i listës përfundimtare të votuesve dhe regjistrimi i votuesve atëherë do ta bëjmë një krahasim të gjithë votuesve dhe, janë kriteret ato të cilat përcaktojnë nëse cili votues i refuzohet vota me kusht. Pra, nëse nuk është i regjistruar në atë komunë, dhe nëse nuk i përputhet

emri, mbiemri apo data e lindjes dhe numri i ID-s i cili, duhet të jetë i njëjte sikur në bazën e të dhënave. Këto janë ato kriteret të cilat e bëjnë votuesin të pa vlefshëm edhe vota e tyre pra nuk mund të kryhet.

Shkurtë..., te kjo çështja..., përpara se me e rekomanduar me e anuluar zarfin, a e bëni ju këtë analizën tashmë me qenë se na ka ardhur rekomandimi me anuluar një zarf..., dhe në një proces tjetër tek zarfet: konkretisht, ajo që po kërkoni ju i paraprin kur zarfi është ose nënshkrimi është, e zarfi nuk është...! Mirëpo, çdo votues ndërlidhet me nënshkrimin në listën përfundimtare të votuesve me kusht, dhe të dhënat të cilat i kanë në zarfin e sigurisë, këto të dhëna nuk përputhen edhe rekomandohen në rastin e caktuar në listën e shkrimeve me kusht zarfi priset, por në këto raste të cilat janë rekomanduar, janë diku rreth 27 raste të tilla. Sa i përket numërimit ose rinumërimit, kemi në dispozicion përmbi tavolinat brenda dinamikës se caktuar ma i lehtë është shumë ma e lehtë se për kuvendin komunal. Ndërsa, sa i përket shpërputhjes, është shumë herët për me folë në këtë fazë, se QNR i korrigjon të gjitha ato mospërputhje dhe për këtë arsyeje një numër shkon sepse nuk ka fletëvotime, apo ka ngatërrim të pikave. Rezultatet do të jenë preliminare, QNR-ja çdo proces që e banë e bën dyfish, janë 4-5 faza që kontrollohet gjithçka, nuk lejojmë mos përputhje në ato raste ku mos te kemi mos përputhje do ti rekomandojmë KQZ-së, dhe jemi akoma në procesin e përpunimit të të dhënave, dhe nuk e kemi përgatitur raportin...

**Ilir Gashi:** Kishte me qenë mirë se, ne e kemi praktikuar kur kemi tentuar që edhe në bazë të ankesave që dalin, m'u rinumëruar... Vetëm për kandidatin që ka fituar të drejt për me u qelë kutitë...Konsideroj që kishte me qenë mirë që, kur të bëhet rinumërimi, të bëhet për të gjithë për faktin se mund të na ndodhë që në të njëjtën kuti, ta numërojmë 1 ose 2 herë, varësisht se qysh vijë ankesat...Kështu, çdo kuti që hapet është mirë, dhe me qen një rinumërim i plotë për gjitha subjekte dhe për gjithë kandidatët, varësisht prej ankesës në mënyra që të mundë të vijë një ankesa, e që pastaj ajo është një çështje e kryer...Ka ndodhë rinumërimi, dhe rezultati është mbi bazën nga ajo se çka ka dalë...

**Binak Vishaj:** Pjesa se çka tha Iliri..., desha prej kësaj të fundit, që të bëhet një rinumërim i pjesshëm, të shkoj komplet për arsyeje se, ta bëjmë një rinumërim nëse ka eventualisht diçka, nëse ja vlen për me u pa aty...! Se, edhe po dua me përgëzua qendrën e rinumërimit, dhe të gjitha ata njerëz që po e bëjnë aty përmbi 24 or me i pa edhe i kemi diskutua është një punë e madhe që po bohet atje, dhe për ata dhe meritojnë përgëzim, po edhe Burimi veçanërisht se, është aty 24 orë vazhdimisht. Ne, personalisht mendoj se duhet me i dhënë prioritet fletëvotimeve për kryetar komunash, fletëvotimet me kusht, qofte kategoria e diasporës, qoftë e persona me nevoja të veçanta, d.m.th., që te j'u jepet rendësi atyre edhe pse ne kemi në rend dite një plan operacione për zgjedhjet e raundit të dytë, që ka me qenë me 19 nëntor...

**Valdete Daka:** Faleminderit...Me sa e kuptova unë, 4 kuti rekomandohen dhe, bëhet fjalë për kryetar komune që të rinumërohen...! Këto katër kuti i kemi me numra, vetëm ta sqarojmë janë 4 kutit për kryetar komune, dhe 21 kuti për kuvende komunale...Dhe rekomandimi është që të rinumërohen plotësisht, ngase këtu po thuhet që 7 të numërohen pjesërisht..

**Burim Ahmetaj:** Vetëm një gabim të vogël se, janë 3 për Kryetarë Komune janë 3... ju kërkoj falje...Do të thotë, është Prishtina një 1 vendvotim nr. 19/18.02, pastaj 1 në Prizren me nr. 2010A/21, dhe 1 vendvotimi në Suharekë me nr. 2423A/02. Këto janë ato 3 vendvotimet për kryetarë komune, e të cilat nevojiten të rinumërohen....

**Valdete Daka:** Atëherë, kush është për këtë rekomandim?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e QNR për rinumërim të plotë të 3 kutive për Kryetar Komune dhe të 21 kutive për Kuvende Komunale.*

**Valdete Daka:** Kemi edhe rekomandimin që 27 zarfe të fletëvotimeve me kusht që kanë mospërputhje mes nënshkrimit dhe fletëvotimit që gjenden në kuti, të refuzohen ose të anulohen si të tilla.

Kush është për...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe këtë rekomandim nga QNR*

**Valdete Daka:** E kemi rekomandimin tjetër që, 111 kuti të procedohen si të rregullta, qoftë për kryetar komune, dhe qoftë për kuvende komunale...Kush është për...?

*Anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe këtë rekomandim nga QNR*

**Binak Vishaj:** Është mirë me sqarua për opinionin dhe për mediat se, sa kuti shkojnë në rinumërim që ne vendosëm sot...Ndoshta për neve është më lehtë me kuptuar por, opinionin ka nevojë me e kuptuar saktë se çka ka vendosur KQZ.

**Valdete Daka:** Po, e them: 3 kuti për kryetarë komune dhe 21 kuti për kuvende komunale ndërkaq janë 27 zarfe apo 27 fletëvotime, raste.

## **2. Raport nga aktiviteti i Sekretariatit**

**Enis Halimi:** Divizioni përkatës gjatë kësaj periudhe, ka dërguar 10749 pako me fletëvotime përmes postës, dhe gjithashtu ka bërë njoftimin përmes e-mail-it të të gjithë votuesve pra, që janë jashtë Kosovës edhe që janë aprovuar suksesshëm për gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim. Deri me datën 28 tetot 2017, ne kemi pranuar përmes postës, 7621 pako me fletëvotime. Prej tyre, do të thotë numri i pakove që janë aprovuar është, 6735 ndërkaq, të refuzuara janë 886. Arsyet e refuzimit mund të grumbullohen në këto 158 të refuzuara që janë për shkak se personat që kanë aplikuar, nuk kanë aplikuar gjatë kësaj periudhe të aplikimit për regjistrim, 12 raste kur aplikuesit të refuzuar gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim, 329 raste janë kur aplikuesit kanë dërguar pako më shumë se një herë, 305 raste janë personat që nuk janë identifikuar por, në pakot e tyre ka pasur vetëm fletëvotime, 82 raste personat që nuk kanë dëshmuar identitetin me dokumentit valid të identifikimit. Në tabelë dhe në email, keni të shpërndarë pakot e aprovuara sipas shteteve, dhe po ashtu, edhe pakot e aprovuara sipas komunave, pra, i keni dy tabelar si për shembull nga Austria, kemi të aprovuara 796, nga Gjermania 846, nga Serbia 2006, nga Zvicra 1335 e kështu me radhë.

Edhe nga komuna ta zëmë si Gjakova, i ka 252, Gjilani 327, Istogu 1413, Peja i ka 300, Graçanica i ka 414 e kështu me radhë, apo për shembull Leposaviqi i ka 222... Faleminderit...

**Valdete Daka:** Faleminderit krye shef. Vazhdojmë me aktivitete e ZRPP-ës. Vazhdojmë me pikën tjetër rekomandim nga ZRPP-ja. Urdhëro drejtoresh.

### **3. Aktivitetet e ZRPP-së**

*Rekomandim për anulimin e ID-kartelave të vëzhguesve të subjekteve politike*

**Miradije Mavriqi:** Faleminderit Kryetare. Duke pas parasysh se raundi i dytë i zgjedhjeve nuk do të mbahet në të gjitha Komunitatet e Republikës së Kosovës, zyra rekomandon që Komisioni Qendror të Zgjedhjeve që të anulohet ID kartelat e vëzhguesve të subjekteve politike që kanë marr pjesë në vëzhgimin e procesit zgjedhor në zgjedhjet e mbajtura me 22 tetor të këtij viti. Këto ID, do të kenë edhe dizajnin tjetër në mënyrë që të mos keqpërdoren, ose eventualisht të përdoren këto kartela edhe në raundin e dytë. Ky ishte rekomandimi i zyrës... Faleminderit...

**Ilir Gashi:** Unë mbështes rekomandimin zyrës për faktin se pasi që është raundi i dytë atëherë mundësia e keqpërdorimit të bexhave nga vëzhguesit e subjekteve politike prej një komune që nuk është në balotazh nuk është pjesë e garës dhe në shkojnë në komunitet tjerë aty mund të kemi telashe tjerë jo vetëm në raport me subjektet tjerë. ndoshta edhe përbrenda tyre...Kështu që unë e mbështes rekomandimin dhe natyrisht, është shumë e arsyeshme që të kemi bexha të tjerë...

**Valdete Daka:** Po vetëm një pyetje për drejtoreshën. Duhet me sqarua se këto begja vlejné për komunitatet ku ka raund të dytë , mirëpo çka do të ndodh me ata që i ka në bexhat që janë në QNR-ë dhe që vëzhgojnë? Sepse ka vëzhgues që janë në QNR-ë dhe vëzhgojnë edhe i kanë bexhat nga raundi i parë, edhe ti sqarojmë të gjitha që mos të na del mandej ndonjë keqkuptim. Edhe një çështje tjetër që unë me sa e di ka pasur subjekte politike që kanë aplikuar për akreditim ditën e zgjedhjeve për vëzhgues dhe ata vëzhgues munden me i keqpërdor ato bexha edhe munden me vëzhgua edhe në QNR-ë pa ndërpre edhe pse e kanë vetëm për ditën e zgjedhjeve.

**Adnan Rrustemi:** Mirë që po ndërmerret ky veprim sa për ta dallua këtë aspektin e vëzhgimit kur bëhet fjalë për subjektet politike duhet ti kemi disa gjëra të qarta d.m.th. e para, a kërkohet nga subjektet politike me i sjell edhe njëherë listat për akreditim apo janë të mirëqena listat e 22 tetorit. Sepse ne e dimë këtë procesin e akreditimit, vëzhgimit. E dyta, është që po ashtu e dimë që po ashtu subjektet politike që të puna e vëzhguesit nuk ndërlidhet me komunën përkatëse. Subjektet politike mund të përdorin vëzhgues edhe nga komuna tjetër për ta monitoruar dhe vëzhguar procesin zgjedhor në komunën tjetër d.m.th. nuk është e lidhur me të qenit votues i asaj komune. Vëzhguesi nuk e ka të obligueshme që të jetë votues i komunës ku mbahen zgjedhjet, mund të jetë edhe nga komunitet tjerë d.m.th. nuk është si komisionari që kërkohet domosdoshmërisht të jetë votues në atë komunë. Do të thotë, secili subjekt politik po mund të marr vëzhgues nga Prishtina të dërgoj në Prizren për me monitoru procesin zgjedhor janë dispozita tjerë të cilat e përcaktojnë se sa vëzhgues mund ti ketë në vendvotim si administrata procesi por, nuk ka kufizime origjinën e vëzhguesit, për këtë të jemi të qartë. E treta, përveç asaj që e tha kryetarja mendoj që me dizajnin e ri të bexhit përveç që duhet të njoftohen trupat e administrimit të zgjedhjeve KKZ-ët dhe KVV-ët mendoj që duhet m'u njoftuar edhe policia e Kosovës edhe Prokuroria duhet ta dinë sepse është e pamundur ajo që e tha kryetarja se e ngriti me të drejtë çështjen në s'kemi me mëri madje as nuk kemi të drejtë dhe është edhe e pamundur me ja kërkuar tash bexhat që i kemi shpërnda me 22 tetor, e që janë 25-30 mijë me i kthye për m'i marrë

bexhat, d.m.th .ata do të mbesin në duart të vëzhguesve...Ne, si me thënë po vendosim për dizajn të ri të bexhave për raund të dytë, e tash duhet me u njoftuar policia, prokuroria në rastet ku hasim në vëzhgues të cilët i përdorin bexhat e 22 tetorit e që janë të lesuar nga KQZ-ja le ta dinë që është veprim i paligjshëm d.m.th . këtu e kish si çështje që me gjithat edhe ajo që është në QNR-ë është e vërtet mendoj që në sqarim duhet me theksuar se QNR-ja bënë përjashtim se nuk kemi ne mundësi më me leshu në këtë fazë bexha për vëzhguesit e subjekteve politike në QNR-ë ndërkohë që atje ka filluar procesi edhe i administrimi të materialeve por edhe i vëzhgimit.

**Ilir Gashi:** Natyrisht që ne së pari duhet mi deklaruar, m'i shpall si të pavlefshëm bexhat që ekzistojnë, pastaj vazhdojmë me bexhat me dizajnin e ri, e dyta QNR-ja do të bëjë përjashtim sepse, është më lehtë e administrueshme, dhe subjektet politike kur ju kërkohet me pas vëzhgues në QNR-ë mund të qojnë me lista, është shumë letë me i verifikuar, mund të jenë bexhat, dhe kjo vlen të ceket se mund të jenë vetëm për QNR-ë të janë valid ata vëzhgues që qohen me emra e mbiemra nga subjektet politike për me vëzhguar procesin atje.

**Binak Vishaj:** Më së lehtë është me i evidentuar në QNR-ë. Subjektet politike kanë të drejt m'i pas për shembull, 10 vëzhgues ...Këta vëzhgues, duhet të pajisen me ID që janë të lëshuar prej zyrës për regjistrim të partive politike që janë valid d.m.th., ne sot i anulojmë krejt ID që i kanë vëzhguesit për krejt komunat, apo vetëm për komunat që shkojnë në raundin dytë, d.m.th., i anulojmë krejt ID e rëndit të parë, dhe tash bëhet një dizajn i ri me ngjyra të reja...Duhet t'i njoftojmë trupat tanë zgjedhor fillimisht, sepse ata munden me pas probleme me komisionet komunale dhe me këshillat e vendvotimit, pastaj, ta njoftojmë policinë ngase, ata janë përgjegjës për siguri dhe munden me pas informacionin e parë... Ndërsa QNR-ja, e ka më së lehti, i ka 10, i sjellin emrat, pajisen me ID valide dhe hyn brenda d.m.th., është numri i përcaktuar... Vetëm që unë jam që partive te ju dërgohet me shkresë, dhe lypet prej partive që ata t'i qojnë emrat për vëzhgues tash...

**Valdete Daka:** Atë deshtë me thënë që ti konfirmojnë emrat e vëzhguesve të cilët i kanë dërguar për herën e parë d.m.th .i konfirmojnë edhe thonë po i kemi përsëri 5 mijë 2 mijë 1 mijë apo sa edhe këto janë emrat e atyre ose në qoftes i heqin ndonjë thonë që i kemi largu si vëzhgues, edhe të ju japim një afat që t bëhet ky ndërrim. Të ju japim dy tre dite sepse deri sa të prodhohen ID e reja ata duhet me vëzhguar në QNR-ë d.m.th. të ju jepet një afat prej dy tri ditëve edhe kompanisë se nuk mundet kompania brenda natës.

**Adnan Rustemi:** Jo, ç 'është e vërteta nuk e di sa është analizuar ky veprim , se duhet me pas parasysh se qysh duhet me administrua d.m.th., apo ka me bë një njoftim sepse, duhet me pru një njoftim subjektet politike një listë veç, është dashtë pak më shumë shpjegim në rekomandim...Me një farë mënyre, do të bëjmë akreditim të tërthortë se duhet t'i sjellin listat edhe një herë subjektet politike për ata vëzhgues që po dojë m'i përdorë në raundin e dytë d.m.th., nëse i ka akredituar 5 mijë vëzhgues me 22 tetor, mbase do ti bien 12 mijë në raundin e dytë m'i marr bexhat që nënkupton edhe ri akreditimin, natyrisht domosdoshmërisht pa vendim të KQZ-ës për sa kohë i kemi akreditu njëherë por, është edhe një aspekt tjetër kur bëhet fjalë për vëzhguesit e shoqërisë civile. Kjo, krijon një lloj konfuziteti në administrim, Unë, qartë e kam: këtu po i bjen që ke me pas një vëzhgues në ditën e zgjedhjeve me bexh të verdh, e një me të kaltër po e zëmë, ose të portokalltë a çfarë kanë qenë... Kjo është ideja edhe për autoritetet e tjera, në këtë rast, edhe për kryesues...Ata, për me ditë qartë që për shoqëri civile nuk paska qenë e nevojshme me ndërruar, e për subjektet politike paska qenë... A, në ndërkohë, kemi 5 mijë vëzhgues të shoqërisë civile...



**Valdete Daka:** Për deri sa i kanë të vlefshëm do me thënë me datë edhe shoqëria civile edhe vëzhguesit ndërkombëtarë, krejt janë me ngjyra të ndryshme, d.m.th., për ata nuk do të vlej kjo, por vetëm për subjekte politike.

**Adnan Rrustemi:** Atëherë, unë propozoj që bexhat edhe shoqërisë civile në qoftes vendosen me ndërruar, duhet me e ndërruar edhe dizajnin për të gjithë vëzhguesit vendor, kjo është pjesë e administrimit, e sjell listën edhe njëherë secila organizatë vëzhguese dhe ja printojmë bexhat me ngjyrë për raund të dytë.

**Ilir Gashi:** Është pak më lehtë se ata mund të ri konfirmojnë numrat e tyre edhe , data baza ekziston edhe zyra vetëm e procesin me prodhimin e tyre.

**Miradije Mvriqi:** Nëse subjektet politik e ndërrojnë ndonjë vëzhgues ose vijnë vëzhgues të huaj, atëherë tjetër është ajo...

**Adnan Rrustemi:** Aktivitetet në QNR-ë aktualisht janë si të themi vazhdimësi e raundit të parë, nuk kanë ndërlidhje me raundin e dytë...Ne po marrin vendim për bexhat për raundin e dytë të cilët, fillojnë të kenë efekte nga dita zgjedhjeve e raundit dytë e tutje, kështu që le të vazhdojnë vëzhguesit e subjekteve politike në QNR-ë me bexhat aktual...S'kemi pse me i ndryshua, ndërkohë në raundin e dytë në QNR-ë s'mund t'i përdorin bexhat e raundit të parë, s'ka kurrfarë ndërlidhje..., le të vazhdojnë ata të vëzhgojnë. Ne, anulimin e bëjmë për ditë e zgjedhjeve të raundit të dytë...

**Valdete Daka:** Vetëm një moment, mos të krijojnë konfuzion...këto bexha që i kanë të portokallta, vazhdojnë me qenë të vlefshme deri në ditën e zgjedhjeve, atëherë ku është ideja e anulimit sot...? Duhet me sqarua që ato bexha nuk vlej në ditën e zgjedhjeve për 19 nëntorin , ndërkaq për ditën e zgjedhjeve dhe për pjesëmarrje mandej në vëzhgim të ri numërimit, do të vlejë ato bexhat tjerë, cilën do ngjyrë që ta kenë...

**Ilir Gashi:** E para, deri me 19 nëntor, ne e kemi një vazhdimësi të procesin dhe nuk kemi as një problem me vëzhgues të asnjë komune, dhe jo vetëm në QNR, ata mund të vazhdojnë..

**Valdete Daka:** Po i bie se këto anulohen vetëm për ditën e zgjedhjeve, dhe do të jenë të vlefshme deri në ditën e zgjedhjeve me 19 nëntor...Ne, i pajisim OJQ-të dhe subjektet politike me bexha të ri me ngjyrë të re, ndërsa për punëtorët mbesin ato të vjetrat...A është e qartë...Kush është për...?

*Anëtarët e KQZ-së, u dakorduan që të përdoren bexhat e vjetër meqë, procesi është në vazhdim e sipër, kurse për raundin e dytë do të prodhohen bexha të ri.*

#### **4 Raport i Këshillave të KQZ-së**

##### **Këshilli për Operacione Zgjedhore:**

*Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit operacional për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale 2017*

**Adnan Rrustemi:** Këshilli i Operacioneve Zgjedhore në mbledhjen e sotme, ka shqyrtuar në draft - plan operacional për zgjedhjet lokale të 19 nëntorit për komunat që kanë shkuar, ose do të shkojnë në balotazh. Natyrisht, ky dokument që është i zakonshëm, e obligon KQZ-së me këto trupa të

administrimit të zgjedhjeve nga ky moment, e deri më 19 nëntor, ashtu si edhe për aktivitet e tjera pas zgjedhjeve. Ky dokument, e obligon KQZ-në për zbatimin e aktiviteteve që parashihen me ligj dhe rregulla për përgatitjet teknike: lista e votuesve , shpërndarja e fletëvotimeve jashtë vendit dhe aktivitet e tjera në terren siç janë Këshillat e Vendvotimeve, informimi publik i votuesve, aktivitet e tjera lidhur me siç themi: me akreditimin shtesë të vëzhguesve ne raundin e dytë, shpërndarjen e materialeve deri në ditën e zgjedhjeve, administrimin e operacioneve siç është periudha e votimi përmes postës që është paraparë për 14 ditë: fillon me 4 nëntor, dhe përfunduar me 7 nëntor, akreditimi i vëzhgueseve shtesë për organizatat, fushata parazgjedhore etj. E rekomandojmë KQZ-n që ta miratoj si të këtillë planin operacional...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan draft – planin operacional për Raundin e Dytë për Kryetar Komune nga Zgjedhjet Lokale 2017.

**Valdete Daka:** Bexhat e raundit të parë, vlejné për mediat...

## **5. Twa ndryshme**

**Për KQZ**

**Valdete Dak, kryetare**

-----